

RELACION PËRSHKRIMOR

OBJEKTI:

RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS “MUSTAFA MATOHITI”



ADRESA:

Lagjia “Mustafa Matohiti”, Bashkia Patos

1. Vendodhja

Shkolla “Mustafa Matohiti” ndodhet në pjesën jug-lindore të qytetit të Patosit. Ajo pozicionohet në lagjen “Mustafa Matohiti”. Sipërfaqja përreth territorit të shkollës është rreth 1534.5m². Sipërfaqja e godinës është 835m² dhe sipërfaqja e palestrës e cila do të ndërtohet është 375m².

2. Përshkrimi i situatës ekzistuese

Shkolla “Mustafa Matohiti” është një godinë 3 kate në të cilën vërehet mungesë e përgjithshme e hapësirave funksionale dhe ka mungesë të theksuar në infrastrukturën e saj. Kjo shkollë shërben si shkollë 9-vjeçare dhe gjimnaz njëkohësisht numri i nxënësve në këtë shkollë arrin 700 nxënës.

Sapo paraqitesh në ambjentet e shkollës “Mustafa Matohiti” ndeshesh me problematike nga më të ndryshmet ndër to përmendim:

- Instalimet elektrike, problemet me tarracën, ujrata e zeza dhe problemet e tjera fizike;
- Probleme me ujë dhe higjienën e objekteve hidrosanitare;
- Mungesë në zhvillimin e mësimdhënies për orët laboratorike;
- Kushte jo të favorshme për zhvillimin e mësimin në klasa për shkak të gjendjes së rrënuar të klasës, problem me dyert, dritaret, tavolinat dhe karriget e nxënësve.
- Problemë tjetër që vihat re është sigurimi i ngrohjes gjatë stinës së dimrit;
- Ambjentet sportive si palestra, fusha e futbollit etj janë elemnt të cilët nuk egzistojnë në këtë shkollë.
- Sigurimi i sistemit të komunikimit në rast të emergjencave dhe situatave të tjera të papritura.
- Sigurimi i temperaturës normale për mjediset e brendshme të shkollës në kohën e verës dhe të dimrit.

3. Përshkrimi i projektit

Përmirësimi i kushteve arsimore është një hap i nevojshëm për një të ardhme të sigurt është qëllimi kryesor i hartimit të këtij projekti. Rikonstruksioni i plotë i kësaj shkolle do të ndikonte në mirëqënien e nxënësve dhe në funksionimin normal të procesit mësimor.

Në projekt është parashikuar:

- Të hiqen të gjitha suvatimet ekzistuese si dhe zvendesimin e dyerve dhe dritareve të vjetra me dritare duralumini dopio xham .
- Të gjitha katet do të jenë të shtruara me beton nivelues si dhe pllaka grez porcelani.
- Do të merren masat e nevojshme për hidroizolim të ri të objektit me shtresë guajn 3.2-4 mm si dhe do të bëhet rinivelimi i soletës për largimin e ujrave. Gjithashtu do të vendosen ulluk dhe kaseta të reja shiu.
- Dyert e klasave do të jenë prej druri kurse dyert ku ka kontakte me ujë do të jenë duralumin. Dritaret do të jenë me xham të dyfishtë;
- Tualetet do të ndërtohen duke instaluar të gjitha pajisjet e nevojshme sanitare. Masa për ujë, pusetat e kanalizimeve do të ndërtohen në anën e jashtme;

- Sistemi i ngrohjes së shkollës do të sigurojnë temperaturë normale ajo përfshin instalimin e sistemit, si dhe instalimin e furrës dhe radiatorëve;
- Sistemi i mbrojtjes nga zjarri do të instalohet në shkollë. Ky sistem përfshin sinjalin e alarmit automatik, bombulat e fikjes së zjarrit si dhe gjithë infrastrukturen e nevojshme .
- Gjithashtu do të kihet parashyesh instalimi i gjithë skemes së rrjetit elektrik dhe të telekomunikacionit, për gjithë godinen e shkollës por edhe krijimin e infrastruktures së nevojshme për laboratorët mesimorë.
- Në lidhje me aktivitetet mesimore është menduar ndërtimi edhe i një godine shtese të shkollës që do të funksionojë si palestër e mbyllur dhe e pajisur me gjithë infrastrukturen e nevojshme..Ndërsa për ambientet rrethuese të godinës është menduar disiplinimi i tyre duke bërë sistemin e sheshit para godinës si dhe ndërtimin e një kende mesimdhënie për gjimnastikën si dhe rrethimin e gjithë territorit me mure me blloqe si dhe portën kryesore.
- Fusha e jashtme është parashikuar të vishet me gome dhe rezine me veti anti-shok, për parandalimin e goditjeve.
- Gjithë godina do të vishet me sistem kapot për të pasur një efikasitet më të madh të energjisë.

Punoi:

Specialiste Hartimit dhe Aplikimit të Projekteve

Blerina Halidini